

**INFORMACION NË LIDHJE ME KOMENTET/REKOMANDIMET/OPINIONET E PALËVE TË
INTERESUARA/GRUPEVE INTERESI, SI DHE PROCESIN E SHQYRTIMIT TË TYRE, PËR PROJEKTAKTET E
KONSULTUARA, GJATË VITIT 2024**

1. Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e forcës rezerviste në Republikën e Shqipërisë”

Nr.	Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	Kuadri ligjor	Kuadri ligjor ushtarak mendoj qe ka ardhur koha për te eliminuar dublimet e përgjegjësiave dhe për ta harmonizuar legjislacionin ushtarak duke hartuar një Ligj "Për mbrojtjen dhe Forcat e Armatosura te RSH" i cili te përmbaje: 1. Dispozitat e përgjithshme, 2. Dispozitat për mbrojtjen (Parimet e mbrojtjes, burimet e mbrojtjes detyrat e institucioneve shtetërore dhe lokale ne funksion te mbrojtjes) 3. Dispozitat për shërbimin ushtarak ne RSH (Këtu te përfshihen edhe nenet e këtij ligji qe ju propozoni) 4. Dispozitat e për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit (këtu dispozitave te ligjit	SHPFA	Refuzuar	Ky koment nuk është marrë parasysh për arsye se propozimi i bërë për këtë projektligj nuk mund të aplikohet në tërësi nëpërmjet këtij kodi, pasi ndryshimet që ndodhin në Forcat e Armatosura janë në vazhdimësi në varësi të situatës si dhe çështjeve të tjera. Aktualisht Ministria e Mbrojtjes nuk ka si objektiv të ndryshojë të gjithë bazën ligjore që shërben për Forcat e Armatosura. Ky koment

		aktual ti bashkohen edhe përgjegjësitë e përcaktuara ne këtë ligj qe ju propozoni) 5. Dispozitat e statusit te ushtarakut 6. Dispozitat e karrierës ne forcat e armatosura. 7. Dispozitat e dërgimit te forcave te armatosura ne aktivitete ndërkombëtare jashtë vendit, dhe kalimit te forcave te huaja brenda vendit. 8. Dispozitat për disiplinën ne FA. 9. Dispozitat për medaljet dhe gradat e nderit ne FA . 10 Dispozitat e fundit dhe kalimtare. Një ligj i tille jo vetëm do te harmonizonte te gjithë legjislacionin ushtarak duke eliminuar dublimet problemet apo gjerat e tepërta por do ti jepte kuptim edhe vete emrit "Ministria e Mbrojtjes"			do të mbahet në konsideratë për të ardhmen.
--	--	--	--	--	---